

Gjykata Themelore Ferizaj-Dega Kaçanik, Divizioni per Kundervajtje ,dhe ate gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me procesmbajtesen Indira Beqa , punetore e kesaj gjykate ,në lenden kundërvajtëse kundër të pandehurit Emrush Suma nga fsh.Dimce ,komuna e Hani Elezit , për shkak të kundërvajtjes nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1.nenpar.1.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare ,e në baze të nenit 31,73,74,199 dhe nenit 9 të Ligjit për Kundërvajtje me dt. 22.11.2013 merr këtë;

A K T V E N D I M

I pandehuri Emrush (Nesim) Suma ,i lindur me dt.27.05.1974 ne fsh.Dimce ,komuna e Hani Elezit ,ku edhe e ka vendbanimin , shqiptar, shtetas i Republikës se Kosoves, I martuar prind I tre femijeve, ka te kryer fakultetin e teologjise dhe juridik , keshilltar komunal ne Asamblene komunale ne Han te Elezit ,i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë sht ë për gje gj ë s

Sepse si zyrtar i larte publik ne pozitën e keshilltarit komunal ne Asamblene Komunale ne Han te Elezit ,nuk e ka bere deklarimin e rregullt vjetor te pasurise prane Agjensise Kunder Korrupsionit deri me datën 31.03.2012.

Me qka ka kryer kundervajtje nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.1.1 Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare

Andaj në bazë të nenit 31,73,74 dhe 199 te Ligjit per Kundervajtje dhe nenit 17 par 1 nenpar.1 te Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare,

D E N O H E T

Me denim me gjobe në shumë prej 300 € (treqind euro) ,te cilin eshte e obliguar qe ta paguaj në afat prej 15(pesëmbëdhjete) ditësh nga dita e plotfuqishmërise të këtij aktvendimi,në të kundërtën ,konform nenit 5 al.1 të Ligjit per kundërvajtje,dënimi me gjobë do t'I zevendesohet me denim me burg ashtu qe per qdo dite burgu do t'I llogariten nga 15 (Njëzet) €

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KËRRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. _____	Nr. Prot. _____
Dep. <u>DPK/DMP</u>	S. Prot. <u>03-4082/13</u>
Dep. _____	Prot. No. _____
Nr. Fraq _____	Data _____
Broj. stranica <u>03</u>	Qatum. <u>27-11-2013</u>
Nr. pages _____	Dati _____

Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaje pranë kësaj gjykate shumë prej prej 5.00 € ne emer te paushallit gjyqesor në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërise së këtij aktvendimi nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë.

A r s y e t i m

Agjensia Kunder Korrupsionit ne Prishtine , ka parashtruar kërkesen per fillimin e procedures kundervajtese nr.01-2346/12 te dates 02.07.2012 , kunder te pandehurit Emrush Suma nga Hani Elezit ,per kundervajtje nga neni 5 ,6 dhe 9 i sanksionuar me nenin 17 par 1 nenpar.3 të Ligjit per deklarimin ,prejardhjen dhe kontrollin e pasurise se zyrtareve te larte publik dhe deklarimin,prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat zyrtare, dhe ka kerkuar qe I njehti te shpallet fajtor dhe te denohet sipas ligjit.

Ne baze te kerkeses se parashtruar i pandehuri eshte marre ne pyetje nga ana e gjykates me te cilin rast I pandehuri ka deklaruar se ka qene I njoftuar me kohe per obligimin e deklarimit te pasurise nga sekretari I kuvendit te komunes se Hani Elezit ,Avni Bushi ,por qe e ka neglizhur dorezimin e ketij formulari ne Agjensine Kunder Korrupsionit ,dhe dhe shton se ne asnje moment nuk ka patur per qellim qe t'I ik obligimit ligjor te deklarimit te pasurise .

Gjykata, per te konstatuar faktin se I pandehuri Emrush Shkreta a ka qene I njoftuar me kohe nga ana e zyrtareve kompetente komunal per obligimin e deklarimit te pasurise mori ne pyetje ne cilesi te deshmitarit kryesuesin e kuvendit komunal te Hani Elezit I cili ne fjalen e tij deklaroi se :keshilltari komunal Emrush Suma ka qene i njoftuar me kohe per obligimin e deklarimit te pasurise prane AKK,se ne Prishtine si nga ana e tij por edhe nga ana e sekretarit te Kuvendit te komunes se Hanit te Elezit,Avni Bushi dhe ate para dates 31.03.2012 dhe per ta vertetuar deklaraten e tij ka prezentuar para gjykates kopjen e e-mailit te sekretarit te kuvendit te komunes Avni Bushi te dates 17.03.2012,nga I cili konstatohet se keshilltari komunal Emrush Suma ka qene i njoftuar permes e-mailit te tij per obiligimin e deklarimit te pasurise prane AKK,ne Prishtine.

Në bazë të dhënave si në kërkesë , deklaratës së të pandehurit , deklarates se deshmitarit Mendu Vlashi,njoftimit te dates 17.03.2012 dhe shkresave tjera te lendes , gjyqtarja konstatoi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës kundërvajtëse nga neni 8 par 1 I sanksionuar me nenin 17 par.1 nenpar.1.1 pasi qe me Ligjin nr.04/L-050 te gjithë keshilltaret komunale te Asambleve komunale jane perfshire ne listen e zyrtareve te larte qe njeherit edhe kane obligim deklarimin e rregullt vjetor prane AKK,se ne Prishtine,dhe per mandatin sa jane ne kete pozite kane per obligim deklarimin e rregullt vjetor te pasurise se tyre, dhe rrjedhimisht obligimi I deklarimit te pasurise del sipas ligjit, edhe nese agjensioni nuk kerkon deklarimin e pasurise.

Andaj gjykata duke u bazuar ne te theksuarat me larte ka bere rikualifikimin juridik te kundervajtjes dhe te pandehurin conform nenit 17 par.1 nenpar.1 e shpalli përgjegjës dhe e dënoi me denim me gjobë në shumë prej 300 € (treqind euro) , te cilin eshte e obliguar qe ta paguaje ne afat prej 15 ditesh pas plotfuqishmerise se ketij aktvendimi ne te kunderten conform

